



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2882 Prot.

Lezhë, më 21 . 03 . 2021

V E N D I M

Nr 43 , Datë 24 / 02 / 2021

“ Për ndryshimin e pjeshëm të VKB Nr. 94, datë 25.06.2020 të listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohet të transferohet në pronësi të Njësive Administrative Kolsh, Bashkia Lezhë.”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nëni 9 pika 1.2 gërma a, në ligjin nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit” nëni 8, i ndryshuar, në ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” seksioni IV, në VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” si dhe në Udhëzimin nr 3 datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”, duke qenë se ky proces është i papërfunduar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së pjeshëm të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi apo përdorim të Njësive Administrative Zejmen - Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.
 - a. Lista e inventarit me numrin 201, Tregu Rajonal Tresh, fshati Tresh, Komuna Zejmen.
2. Paraqitjen e listës së pjeshëm përfundimtare për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Ngarkohet Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

